



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 107, datë 29.02.2024

**PËR
PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË KOMANDIMIT TË Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 538, datë 14.12.2022 “Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë”, shkresën nr. 1199 prot., datë 26.02.2024 të Ministrisë së Drejtësisë, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin para afatit të komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit” në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Efektet e këtij vendimi fillojnë menjëherë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës dhe Ministrisë së Drejtësisë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR